



NXEHTËSIA E TOKËS

Energji alternative
edhe në **SHQIPËRI**

THE EARTH HEAT
an alternative energy
in **ALBANIA**

....Mjedisi i ynë na ofron dy burime, Diellin dhe Tokën, tërësisht të ndryshme, për të plotësuar nevojat tona. Dielli na jep energjinë drejtpërsë drejti ose têrthorazi, energjinë e erës, të ujit dhe të biomasës. Por Dielli është lozonjar, na bën të varur nga koha e ditës dhe natës, nga moti dhe klima. Toka paraqet vështirësi, por është e sigurtë: potenciali i saj është i disponueshëm në çdo kohë, ai vetëm duhet shfrytëzuar me teknologjitet e përshtatshme!

Deklarata e Ferrarës, Itali, 29-30 Prill, 1999
Këshilli European i Energjisë Gjeotermale




SHOQATA "MBROJTJA DHE RUAJTJA E UJERAVE TE EMBLA DHE BREGDETARE TE SHQIPERISE
ASSOCIATION OF ALBANIAN INLAND AND COASTAL WATER CONSERVATION AND PROTECTION

Projekti: RRUGET E SHFRYTËZIMIT TË DREJTPËRDREJTË TË ENERGJISË SË RINOVUESHME GJEOTERMKE MIQËSORE ME
MJEDISIN NË SHQIPËRI
DIRECTION OF DIRECT USE OF RENEWABLE ENVIRONMENTAL FRIENDLY GEOTHERMAL ENERGY IN ALBANIA

TOKA - KY PLANET I NXEHTË!

Sipërfaqja e Tokës është dëshmitare e shfaqjes, shpesh herë të fuqishme e brutale, të energjive të brendshme të Planetit. Këto energji grupohen në dy kategori:


Energjia mekanike e tërmeteve dhe Energjia termale e vullkaneve



Vullkanet dhe geizeret


janë dëshmi të energjisë së madhe termike të Tokës.

Toka është një planet i nxehtë. Në qendër të saj, përllogaritet që temperatura të jetë rrëth 4000°C . Fluksi i nxehtësisë, që vjen nga thellësitë në sipërfaqen e Tokës luhatet mesatarisht nga 54.4 mW/m^2 në kontinente, deri 67 mW/m^2 në oqeanë. Planeti shpërndan në sipërfaqe një sasi nxehtësie që arrin deri $42 \text{ miliardë kilowat}$.



Nga thellësitë e nëntokës fluksi i nxehtësisë drejtohet për në sipërfaqen e Tokës

Geizer në Zelandën e Re
(Sipas W.A. Elders)



Toka ka burimet e veta, të cilat gjenerojnë nxehtësi:

- të mbetur nga koha e formimit të planetit (26-52% e totalit),
- të ciruar nga zërthimi i elementëve radioaktivë që përmban lënda e Tokës (22-47%),
- të ciruar nga kristalizimi i minraleve dhe nga diferencimi gravitativ i lëndës (4.7-9%),
- të ciruar gjatë lëvizjeve tektonike dhe tërmetet (0.8%).

Mesatarisht, temperatura e Tokës rritet me thellësinë sipas një shkalle gjeotermike $\text{Sh} = 1^{\circ}\text{C}$ çdo 32 m, duke patur një gradient gjeotermik $3.12^{\circ}\text{C}/100\text{m}$.

ENERGJIA GJEOTERMALE

Sistemi energjetik:

1. Lëndë djegëse: - Të ngurta (Qymyr guri dhe torfa)
- Të lëngëta (Nafta)
- Të gazta (Gazi djegës)
2. Energjia termobërthamore
3. Energjitet e rinoreshme (energji të bardha, ekologjike): E ujit
- E biomasës
- Gjeotermale
- E Diellit
- E erës

Në vendet e përparuara Europiane është intensiv shfrytëzimi i energjive të rinoreshme, miqësore me mjeshtir. Aktualisht, p.sh. në Zvicër, prodhimi i energjive nga burime të ndryshme, është si më poshtë:

- Energjia e biomasës (druri)	5720 GWh, ose 81.5 % e totalit
- Gjeotermale	618 GWh, ose 8.7%
- Energjia e Ajrit dhe ujit	412 GWh, ose 5.8%

Energjia gjeotermale merret nga nxehësia e çliruar nga:

1. Shkëmbinjtë e thatë, me anën e Këmbyesve Vertikalë të Nxehësisë në shpime,
2. Ujërat termale të cilët kategorizohen:

Entalpia e lartë. Fumarola (avulli dhe uji shumë i nxehët) që shpërthen në sipërfaqe përbëhet nga ujë i valuar dhe avuj me temperaturë të larta, që arrijnë deri në 310°C në rezervuarin nëntokësor. Tipikë janë geizeret, midis të cilëve është i famshmi "Gejzeri" i Islandës. Shatërvani i ujit në geizerë arrin deri $40\text{-}42\text{ m}$ lartësi dhe ai i avullit deri 150 m .

Entalpia e mesme. Fluidi (uji dhe avulli) gjeotermal ka temperaturë që luhatet nga 80°C deri në 150°C .

Entalpia e ulët. Uji del në sipërfaqe në formën e burimeve, ose me anën e shpimeve. Ka burime me ujë të ngrohtë ($27^{\circ}\text{C}\text{-}37^{\circ}\text{C}$), me ujë të nxehëtë ($37^{\circ}\text{C}\text{-}42^{\circ}\text{C}$) dhe shumë të nxehëtë (42°C deri 80°C).


Energjia gjeotermale e entalpisë së lartë shfrytëzohet:

1. Kryesisht për prodhimin e energjisë elektrike. Në vitin 2000 fuqia e instaluar ka qenë $9\,960\text{ MWe}$, në nivel botëror.
2. Për ngrohje, në industri dhe në bujqësi.

Uji i rreshjeve atmosferike përshkon shkëmbinjtë nëpermjet poreve e çarjeve të tyre dhe futet në thellësi të mëdha. Atje, ngrohet nga nxehësia që merr nga shkëmbinjtë, të cilët janë burimi parësor i energjisë gjeotermale dhe mbas kësaj, kryesisht, nëpermjet thyerjeve tektonike del në sipërfaqe, në formën e burimeve ose të geizerëve. Këta janë burimet dytësore të nxehësisë.



I famshmi "GEJZER" në Islandë
(Foto- ORKUSTOFNUN)




PERDORIMI I DREJTPËRDREJTË I ENERGJISË GJEOTERMALE NË BOTË

WORLD-WIDE DIRECT USE OF GEOTHERMAL ENERGY

Energjia gjeotermale shfrytëzohet edhe drejtpërsëdrejti, gjërësisht në shumë fusha të veprimtarisë jetësore dhe ekonomike. Në nivel botëror, në vitin 2000 fuqia e instaluar për shfrytëzimin e drejtpërdrejtë të kësaj energjie, ka patur këtë strukturë:

- Për ngrohje me pompa nxehtësie	6 849 MW
- Për ngrohjen e godinave me ujë të nxehtë	4 954
- Për klinika dhe pishina për banjë dhe notim	1 796
- Për ngrohjen e sérave	1 371
- Për akuakulturë	525
- etj
Total	16 209 MW

Në vendet fqinjë të Europës jugë-lindore, energjia e përdorur është (në GWh/vit): Itali 1048 , Rumani 797, Bullgari 455, Kroaci 154, Slloveni 196,



Pishinë termale. Hotel Budapest
(Foto Prof. J.W.Lund)

Përdorimi i drejtpërsëdrejti i energjisë gjeotermale është shumë i larmishëm:

Së pari, përdorimi i ujit të nxehtë të burimeve dhe puseve.

Përdorimi klasik i ujërave termale në të kaluarën ka qënë i kufizuar. Ato janë shfrytëzuar vetëm për kurimin e sëmundjeve të ndryshme në të ashtuquajturat "Llixha". Por në çerek shekullin e fundit u bë një ndryshim në koncept. Sot, ujërat termale konsiderohen se janë të dobishme dhe duhen përdorur gjërësisht për kalitjen e shëndetit të njerëzve të shëndoshë dhe për dëfrimin e tyre, që janë edhe shumica e popullsisë, si edhe për kurimin e sëmundjeve. Prandaj ndërtohen dhe shfrytëzohen hotele turistike me pishina dhe banja me ujë të ngrohtë, krahas klinikave të "Llixhave".

Ngrohja e sérave për prodhimin e luleve dhe të perimeve është një nga drejtimet e rëndësishme të përdorimit të energjisë gjeotermale.

Nxjerra e mikroelementeve dhe kripërave natyrore nga ujërat termale minerale është një veprimtari ekonomike me shumë vlerë .



Southampton Grand Hotel, Angli (Foto M. Smith)



Hotel Arthur Beppu, Japoni



Serë
(ORKUSTOFUN,
Islandë)



Fermë për rritje rrasati peshku
(ORKSUSTOFUN- Islandë)

**Me ujin e nxehthë ngrohen edhe basene
ujore për rritjen e rasatit të peshqve, si edhe
për rritjen e algave të ndryshme.**

**Me kripërat dhe nga alget prodhohen
edhe pomada, nga më të mirat, për kurimin
e sémundjeve të ndryshme të lëkurës dhe
për kozmetikë.**


Së treti, përdorimi i sistemit Këmbyes Nxehtësie-Pus (KNP)-Pompë Nxehtësie (PN) për ngrohjen e banesave. Aktualisht këto janë sistemet më moderne, me teknologji më të përparuar, miqësore me mjedisin dhe po bëhen gjithnjë e më shumë popullore. Në shumë vende të Komunitetit European bëhen përpjekje të mëdha për të reduktuar varësinë e tyre nga karburantë i importuar për ngrohje. Burimet vendore të energjisë, siç është nxehtësia e shtresave pranësipërfaqsore janë veçanërisht në fokus, edhe përpjekjeve e tyre, lidhur me efektivitetin e lartë ekonomik, si edhe për mbrojtjen e mjedisit nga efekti serë, i shkaktuar nga




Blok baneshash komunale, Hollandë
Sipërfaqja e ngrohur 7900 m²

Në 26 shtete, deri më sot janë montuar 570 000 instalime BHE-HP, më fuqi 12 KW secila, për ngrohjen dhe freskimin e shtëpive-vila, por ka edhe mijëra instalime me fuqi deri 500 KW që shërbejnë për ngrohjen e institucioneve dhe të blloqeve të banesave komunale. Shembull tipik është Zvicra, ku ka 21 000 instalime, me fuqi të pompës nga 19-40 KW, të cilët shfrytëzojnë nxehtësinë e shtresave pranësipërfaqsore të tokës me temperaturë rreth 10°C. Nëse, p.sh., në vitin 1980 prodhimi i energjisë gjeotermale nga këto sisteme në Zvicër ka qënë 70 GWh, në vitin 1999 ai arriti në 365 GWh .

Së dyti, përdorimi i puseve të thellë të naftës dhe gazit të braktisur, çift ose të vtmuan për të shfrytëzuar energjinë gjeotermike, si "Burime vertikale drejtvizore nxehthësie". Në puse të vtmuan mund të instalohen sisteme të mbyllur qarkullues së ujit të ftohtë për t'u ngrohur në thellësi. Me anën e konveksionit, uji ngrohet nga nxehthësia e shkëmbinjve. Ai mund të përdoret për ngrohjen e serave dhe të banesave.



Burim drejtvizor vertical nxehthësie



Skema e ngrohjes ë banesave
me sistemin KNP-PN



Godine institucionale, Lion, Francë
sipërfaqja e ngrohur 1600 m². Kosto e energjisë eE/vit.m²

RREGJIMI GJEOTERMAL I ALBANIDEVE


GEOTHERMAL REGIME OF THE ALBANIDES

Temperatura

Fusha gjeotermale karakterizohet nga temperatura relativisht të ulëta. Në thellësinë 100 m temperaturat luhaten nga 8°C deri 20°C. Temperatura arrin deri 68°C në thellësinë 3000 m në rajonin e Myzeqesë. Në thellësinë 6000 m temperatura arrin 105.8°C. Temperatura më të ulëta janë regjistruar në rajonet malore të vendit.

Temperature

Geothermal field is characterized by relatively low values of temperature. The temperature at 100 meters depth varies from 8 to 20°C. The highest temperatures (up to 68 °C) at 3000 meters depths have been measured in plane regions of western Albania. At 6000 meters depth, the temperature is 105.8°C. The lowest temperature values have been recorded in mountain regions.




Harta e Temperaturës
në thellësi 100 m

Temperature Map
at depth 100 m

Harta e Temperaturës
në thellësi 3000 m

Temperature Map
at depth 3 000 m



Harta e Gradientit Gjeotermal
Geothermal Gradient Map


Gradienti gjeotermal

Temperatura rritet me thellësinë sipas një gradienti gjeotermal prej $2.13^{\circ}\text{C}/100\text{m}$ në prerjen gjeologjike argjilore të Pliocenit në rajonin e Myzeqesë. Gradienti gjeotermal arrin vlera deri $3.6^{\circ}\text{C}/100\text{m}$ në brezin e shkëmbinjve magmatikë në zonën tektonike Mirdita, veçanërisht në Shqipërinë jug-lindore, pranë kufirit shtetëror shqiptaro-grek..

Geothermal Gradient

The geothermal gradient displays the highest value of about $2.13^{\circ}\text{C}/100\text{m}$ in the Pliocene clay section at center of Pre-Adriatic Depression. In the ophiolitic belt of Mirdita tectonic zone, the geothermal gradient values increase up to 36 mK.m^{-1} , especially in southeastern Albania, towards the Albanian - Greek border.

HARTA E DENDESISE SE FLUKSIT TERMIK HEAT FLOW DENSITY MAP



Sipas profilit krahinor Albanide-1 rezulton se granitet e bazamentit kristalin në zonën Mirdita janë burimi radiogjen i nxehtësisë, që ka shkaktuar zmadhimin e fluksit të nxehtësisë.

According to the Albanides-1 regional section, it results that the crystal basement granite, have great possibilities to be radiogenic heat source, increasing heat flow density.

Dendësia e Fluksit të Nxehtësisë

Përhapja e fluksit të nxehtësisë në territorin shqiptar paraqet dy veçori:

Së pari, vlera më e madhe e fluksit në rajonet fushore të Myzeqesë është 42 mW/m^2 . Madhësia e dendësisë së fluksit të nxehtësisë arrin deri 60 mW/m^2 në brezin e shkëmbinjve magmatikë në zonën tektonike Mirdita.


Së dyti, në brezin e shkëmbinjve magmatikë vrojtohen disa vatra me dendësi më të lartë të fluksit të nxehtësisë. Këto vatra janë të shkakuara nga transmetimi intensiv i nxehtësisë nëpërmjet thyerjeve të thella tektonike gjatësore e tërthore. Thyerjet tektonike kushtëzojnë edhe vendosjen e burimeve të energjisë gjeotermale, në thellësi rreth 8-12 km, ku temperatura arrin deri 220°C .

Heat Flow Density

The regional pattern of heat flow density in the Albanian territory is presented by two particularities:

Firstly, the maximal value of heat flow is equal to 42 mW/m^2 in External Albanides. In the ophiolitic belt at eastern part of Albania, the heat flow density values range up to 60 mW/m^2 .

Secondly, in the ophiolitic belt there are observed some hearths of higher heat flow density. Heat flow anomalies are conditioned by intensive heat transmitting through deep and transversal fractures. These fractures are conditioned location of the geothermal energy sources. According to the different geo-thermometers calculations, the aquifer estimated temperatures are 144°C to 270°C . Based on the geothermal modeling, it is supposed that thermal waters rises from 8-12 km deep, where temperature attains to 220°C .



ZONAT GJEOTERMALE DHE REZERVUARËT E UJERAVE TERMALË NË SHQIPËRI

GEOTHERMAL ZONES AND THERMAL WATER RESERVOIRS IN ALBANIA

Në Shqipëri ka shumë burime dhe puse të ujërave termale të entalpisë së ulët. Ujërat e tyre kanë temperaturë që arrijnë deri 65.5°C (Fig. 1, Tab. 1).

In Albania there are many thermal springs and wells of low enthalpy. Their water has temperatures that reach values of up to 65.5°C (Fig. 1, Tab.1).

Burimet dhe puset e ujërave termale në Shqipëri

The thermal water springs and wells in Albania



Lloji i burimit	Vendndodhja / Location	Temperatura ($^{\circ}\text{C}$)	Kripëra Salts (mg/l)	Prurja Yeild (l/sek)
Burim natyror Natural springs	Peshkopi, Mamurras (Tiranë), Shupal (Tiranë), Lixha Elbasan, Tervoll (Gramsh), Langaricë (Përmet), Sarandoporo (Lëškovik), Krane (Sarande).	21-60	0.3-26	10-40
Puse të thellë Deep wells	Kozani, Ishëm, Galigat, Bubullimë, Ardenicë, Seman, Verbas.	29.3-65.5	1-19.3	0.9-18
TOTAL				>130

Këto burime të ujërave termale ndodhen kryesisht afër thyerjeve tektonike krahinore dhe në brezat sismikisht aktivë. Në përgjithësi, këto ujëra qarkullojnë nëpër shkëmbinjtë karbonatikë të strukturave të ndryshme dhe të nënshtratit me shkëmbinj kriporë, deri disa kilometra thellë. Ujërat termale përbajnë kripëra, gas të përthithur dhe lëndë organike. Ujërat janë të tipeve sulfate, sulfide, metane, jodure-bromi. Nga puset e thellë, uji termal vjen nga thelli-sitë (800-3000 m) nga rezervuarë karbonatikë ose ranorikë. Burimet dhe puset termale janë të vendosur kryesisht në tri zona gjeotermale:


These thermal water springs are mainly near zones of regional tectonic fractures, in seismic active belts. Generally the water circulates through carbonatic rocks of the structures and evaporitic beds in some kilometers of depth. The water of these springs contains salt, absorbed gas and organic matter. They are sulfide; methane, iodine-bromium and sulfate types. In many deep oil and gas wells there are thermal water fountain outputs. These waters comes from different depth levels (800-3000 m) of limestone and sandstone reservoirs.

HARTA E ZONAVE DHE BURIMET E PUSËT TERMALË

MAP OF THE THERMAL ZONES AND LOCATION OF THERMAL SPRINGS AND WELLS




Pusi gjeotermal Kozani-8
Kozani-8 geothermal well




Profil gjeotermal krahinor Tiranë-Peshkopi. Zona gjeotermale e Krujës
Regional Geothermal Section Tirana- Peshkopi, Kruja Geothermal Zone

Zona gjeotermale e Krujës është zona me resurset më të mëdha gjeotermale. Ajo ka një shtrirje të përgjithshme prej 180 kilometra dhe gjerësi 4-5 kilometra, si edhe ka resurse gjeotermale të identikuara 5.9×10^8 - 5.1×10^9 GJ. Kjo zonë fillon nga bregderi i Adriatikut në veriperëndim të Tiranës dhe vazhdon në juglindje në territorin grek. Ajo përfaqëson një varg strukturash antiklinale me bërthamë karbonatike të mbuluara nga fliishi Paleogjenik dhe nga molasa të Tortonianit. Antiklinallet kanë gjatësi 20-30 kilometra. Ato janë asimetrike dhe krahët e tyre perëndimorë janë të këputur nga thyerjet tektonike.

Kruja geothermal zone represents a zone with the biggest geothermal resources. Kruja zone has a length of 180 km. Identified resources



Pusi Gjeotermal Ishmi 1/b Geothermal well Ishmi 1/b




Profil gjeotermal, Zona Gjeotermale e Ardenicës
Geothermal Section, Ardenica Geothermal zone

Deri tani vetëm disa nga ujërat e burimeve termale, si ato të Llixhave në Elbasan, në Bilaj të Fushë Krujës, në Peshkopi etj. shfrytëzohen vetëm për kurime të sëmundjeve të ndryshme. Ky shfrytëzim

bëhet në mënyrë primitive, si koncept dhe si mundësi zhvillimi.

Until now the thermal waters of some springs and wells in Albania are used with primitive technology only for health purposes.



Profil gjeotermal, Zona Gjeotermale e Krujës
Geothermal Section, Kruja Geothermal zone

Zona gjeotermale e Ardenicës ndodhet në Ultësirën Bregdetare të Shqipërisë, në veri të Fierit. Aty shtrihen struktura e Ardenicës, e Semanit etj. Kjo zonë shtrihet në pjesën e Ultësirës Pranadriatike ku kalojnë thyerje krahinore tektonike. Uji del në sipërfaqen e Tokës nga thellësia nëpërmjet puseve, duke patur temperaturë rreth $32-38^\circ\text{C}$ në sipërfaqe, dhe prurje 15-18 l/sek. Prerja gjeologjike e ujëmbajtësit në këto struktura përfaqësohen nga shtresa ranorësh masivë deri të imët, të veçuar nga shtresa argjilash dhe alevrolitesh. Trashësia e prerjes së ujëmbajtësit arrin disa qindra metra, duke u ndodhur midis thellësive 1-2 km. Shtresat ranore të ujëmbajtësit kanë trashësi nga disa metra deri në 20 metra.

Ardenica geothermal zone is located in the coastal area of Albania, in sandstone reservoirs.

Zona gjeotermale e Peshkopisë ndodhet rreth 2 km në juglindje të qytetit të Peshkopisë. Atje ndodhen disa burime të vendosur pranë njëritjetrit. Në këta burime, uji buron në shpatin e një lumi, që ndërtohet nga depozitime flishore. Burimet lidhen me një zonë të tektonikës shkëputëse të thellë, në periferi të diapirit gipsor. Prurja e disa burimeve arrin deri 14-17 l/sek. Temperatura e ujit arrin deri 43.5°C .


Peshkopia gjeotermal zone at northeastern area of Albania. Several springs are located with disjunctive tectonics of the gypsum diapir.

E NESËRMJA E SHFRYTËZIMIT TË ENERGJISË GJEOTERMALE NË SHQIPËRI

Shqipëria përfaqëson një vend me potencial të energjisë gjeotermale të entalpisë së ulët, që mund të shfrytëzohen për qëllime ekonomike. Përdorimi i energjisë gjeotermale duhet të bëhet me teknologji moderne, me skemë integrale të shfrytëzimit të energjisë gjeotermale: pompa, të nxehësisë dhe të energjisë diellore, si dhe të shfrytëzohet me mënyrë kaskadë, nga temperaturat e larta deri sa të ftohen.

Shfrytëzimi i ujërave termale të burimeve ose të puseve bëhet tërheqës nga fakti se ato përgjithësisht ndodhen në zona të zhvilluara nga ana urbane, me natyrë piktoreske dhe pranë qendrave historike.

Situata gjeotermale në Shqipëri ofron tre drejtime të shfrytëzimit të energjisë gjeotermale, që aktualisht janë pothuajse të pa lëvruara:



Temperatura e shtresave pranësipërfaqësore, Tiranë

Së pari, përdorimi i sistemit Këmbyes Nxehësie-Pus (KNP)-Pompë Termike (PT) për ngrohjen e banesave, duke shfrytëzuar nxehësinë e shtresave pranësipërfaqësore të Tokës. Një këmbyes koaksial ose në formë U-je i nxehësisë instalohet në shpime 30-150 m të thellë. Lëngu që qarkullon nëpër këtë këmbyes nxjerr nxehësinë nga shtresat e Tokës. Këmbyes të shumëfishtë instalohen për të ngrohur godina të mëdha ose për bllok godinash publike etj.

Së dyti, **uji i nxehëtë i burimeve dhe i puseve**. Këto ujëra mund të përdoren në mënyrë kaskade, për hotele me pishina me ujë të ngrohtë për rekreacion, dhe dëfrim të popullsisë duke zhvilluar turizmin, për klinika moderne për mjekimin e sëmundjeve të ndryshme, për ngrohjen e banesave dhe të serave për lule dhe perime, për ferma të rritjes së rasatëve të peshqeve, të algeve, si edhe për nxjerrjen e mikroelementeve dhe kripërave natyrore për pomada për mjekimin e sëmundjeve të lëkurës dhe kozmetikë.

Së terti, përdorimi i puseve të thellë të naftës dhe gazit çift ose të vëtmuar për të shfrytëzuar energjinë gjeotermike, si "Burime vertikale drejtvizore nxehësie". Në 2000m thellësi temperatura arrin vlera 48 °C. Në puse të vëtmuara mund të montojen sisteme të mbyllur qarkullues së ujit të ftotë për tu ngrohur në thellësi. Uji i ngrohur nga nxehësia e shkëmbit gjitet lart dhe mund të përdoret për ngrohjen e serave etj. siç tregohet në figurë.

Shfrytëzimi i energjisë gjeotermale si energji alternative në Shqipëri duhet të fillojë sa më parë, me anën e projekteve të përshtatshme. Investimet për shfrytëzimin e energjisë gjeotermike janë investime të rëndësishme fitimprurëse.

Burim vertikal nxehësie

FUTURE OF THE DIRECT USE OF GEOTHERMAL ENERGY IN ALBANIA

Geothermal situation of low enthalpy in Albania offers three directions for the exploitation of geothermal energy, which is unused until now. This exploitation must realized by integrated scheme of geothermal energy, heat pumps and solar energy, and cascade use of this energy:

Firstly, **space-heating system**, that uses ground heat in the shallow borehole "heat exchanger (BHE)-Heat Pumps system". These systems, actually are presented as the most popular and technologically advanced. Shallow, coaxial or U-shaped BHE's are installed in 30-150 m deep boreholes to extract heat from the ground by closed-fluid circulation. Multiple BHE's are installed for larger units like community buildings etc. In many European Community Countries have been presented great efforts to reduce its dependence from foreign fossil fuels (Rybäch L.et al. 2000). Indigenous sources of energy like that heat content of the subsurface is especially in focus, also due to environmental concern (do not generate any greenhouse effect caused by CO₂ emissions).

Secondly, **thermal sources of low enthalpy** and with maximal temperature up to 80°C. These are natural sources or wells in a wide territory in Albania, from the south near Albanian-Greek boundary to northeast district in Diber Region.

Thermal waters of springs and wells in Albania may be used in several ways:

1. Hotels, with thermal pools, for development of echo-tourism, and modern SPA clinics for treatment of different diseases.

Such centers may attract a lot of clients not only from Albania. The waters have a good curative properties and springs are situated in nice places, near sea side, mountains or Ohrid Lake.

At the present, some private and public SPA, are located in geothermal springs and wells in Albania: **Lixha Elbasani SPA, Bilaj Balneological Center (Ishmi 1/b well), Peshkopia (Diber district) SPA, Sarandaporo (Leskovik District) SPA, Langarica-Ura Kadiut (Permeti District) SPA.** The oldest and most important one is Elbasani Lixha SPA, is located about 10 km south of Elbasani city and 61 km in south-east of Tirana, in the Central part of Albania. By national road communication, Lixha area is connected with Elbasani and Tirana. These thermal springs have been used for about 2000 years. According to historical data there was a thermal center in Elbasani Lixha thermal springs, near of the old road "Via Egnatia" that linked Durresi and Constantinople. There are about 7800 people per year treated for their illness. Lixha Elbasani springs and Kozani-8 well have the possibilities for modern complex exploitation. The beautiful landscape of Elbasani area is not only for medical treatment centers but also as tourist place. This area is located near of the well know pearl, Ohrid Lake, and Gjinari mountaint, with their fantastic forests and nice climate. Ishmi 1/b geothermal well is located in the beautiful Tirana field, near of Mother Theresa (Tirana) Airport, near of Adriatic coastline and Kruja-Skenderbeg Mountain.



Park Hotel- SPA- Lixha Elbasan



Lixha Elbasani thermal spring

3. The hot water can be used also for heating of hotels, SPA and tourist centers, as well as for the preparation of sanitary hot water used there. Near these medical and tourist centers it is possible to built the greenhouses for flowers and vegetables, and aquaculture installations.

4. From thermal mineral waters it is possible to extract useful chemical microelements as iodine, bromine, chlorine etc. and other natural salts, so necessary for the preparation of creams for the treatment of many skin diseases and as beauty care products. From these waters it is possible to extract sulphidric and carbonic gas. It is possible to built installations for processing of mineral waters.

Consequently, the sources of low enthalpy geothermal energy in Albania, which are at the same time the sources of multi-element mineral waters, they represent the basis for a successful use of modern technologies for a complex and cascade exploitation of this energy, achieving an economic effectiveness. Such developments are also useful to open new working places and improv the life level for local communities living near thermal sources.

- **Thirdly, the use of deep doublet abandoned oil and gas wells and single wells for geothermal energy exploitation, in the form of a "Vertical Earth Heat Probe".** The geothermal gradient of the Albanian Sedimentary Basin has average values of about $18.7 \text{ mK}\cdot\text{m}^{-1}$. At 2 000 m depth the temperature reaches a value of about 48°C . Near of these wells, greenhouses can be build .


References

- Frasher A.. 1992 " Geothermy of Albanides". Gethermal Atlas of Europe. Published by Geo Forschung Zentrum Posdam, Germany.
- Frasher A., Liço R., Kapedani N., Çanga B., Jareci E., Çermak V., Kresl M., Kuçerova L., Safanda J., Shtulc P., 1995. Geothermal Atlas of Albania. Committee of Science and Technology of Republic of Albania, Tirana.
- Frasher A., Çermak V., Doracaj M., Liço R., Kapedani N., Bakalli F., Çanga B., Jareci E., Vokopola E., Halimi H., Malasi E., Safanda J., Kresl M., Kucerova L., Stulc P., 1995. Geothermal resources of Albania. Published in "Atlas of Geothermal Resouces of Europe". Hanover 1997.
- Frasher A. 2001. Outlook on Principles of Integrated and Cascade Use of Geothermal Energy of Low Enthalpy in Albania. 26th Stanford Workshop on Geothermal Reservoir Engineering. 29-31 January, 2001, California, USA.
- Rybach L., Brunner M., Gorhan H., 2000. Present situation and further needs for the promotion of geothermal energy in European Countries: Switzerland. Geothermal Energy in Europe. IGA&EGEC Questionnaire 2000. Editors: Kiril Popovski, Peter Seibt, Ioan Cohut.

Temperatura	65.5°C
Prurja	10.3 l/s
Kapaciteti	1.93 MWt
Rezerva specifike	39.6 GJ/m ²
Fuqia e instaluar	2070 kW



ZONA GJEOTERMALE KOZAN



Energjia e humbur për rendiment 0.6
është 253 Milion kWh ~ 20 Milion USD

NJEREZ !
Mos e hidhni këtë pasuri në lumë

Autorë:

Prof. Dr. A. Frashëri, Prof. Dr. N. Frashëri, Prof. Dr. N. Pano, Prof. Dr. S. Bushati
Instituti i Informatikës dhe i Matematikës së Aplikuar kontribuoj për përgatitjen e
broshurës